



Prishtinë: 02.09.2021

Kodi i ZRRE-së: V_1379_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2194_06_21**;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **15.07.2021**.

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin R.M nga Komuna e Prishtinës, me shifër të konsumatorit DPR - 35335, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2194_06_21, i datës 17.06.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 17.06.2021, ka marrë vendim me të cilin është aprovuar pjesërisht ankesa e konsumatorit R.M nga Komuna e Prishtinës dhe është obliguar KESCO që t'i shkarkoj faturat e periudhave 12/2018 në vlerë prej 151.36 EUR, 10/2019 në vlerë prej 407.44 EUR, 02/2019 në vlerë prej 306.50 EUR dhe 03/2019 në vlerë prej 13.68 EUR, si dhe për faturat e cekura si më lartë, ta ngarkoj konsumatorin me shpenzimet e energjisë elektrike të periudhës 12/2019, 01/2020, 02/2020 dhe 03/2020, të njehsorit elektrik nr.44172125.

Kundër këtij vendimi në afatin ligjor ka paraqitur Kundërshtim i licencuari KESCO, për shkak se:

- Faturimi për periudhat 12/2018 dhe 03/2019 me njehsorin nr.44169524 është i saktë dhe është bërë sipas gjendjeve të regjistruara në njehsor;
- DMK vendimin e saj e arsyeton në rrjedhën e energjisë elektrike aktive dhe në krahasimin e shpenzimeve me njehsorin e ri;
- Konsumatori e ka shpenzuar energjinë e faturuar;
- Shpenzimi i konsumatorit në periudhën 11-12/2018, me të njëjtin njehsor është i përafërt me shpenzimin e periudhës kontestuese;
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRrE-së pezullimin e Vendimit ZRrE/DMK_V_2177_05_21 të dt.20.01.2021.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO-s në të cilën pretendohet se faturimi është i saktë, Bordi thekson se pas analizimit të Rrjedhës së Energjisë Elektrike dhe listave të leximit për periudhën para dhe pas kontestit, ka konstatuar se lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektim dhe lexime të rregullta mujore dhe pas krahasimit të shpenzimeve të konsumatorit me tre njehsorët elektrik, njehsorin nr.67239343, njehsorin kontestues nr.44169524 dhe nr.44172125 për periudha të njëjta kohore, dhe vërehet se konsumatori për periudhat kontestuese ka rritje të madhe në shpenzim, krahasuar me periudhat e tjera, por që shihet qartë se konsumatori ka filluar të ketë rritje të shpenzimeve nga periudha 05/2018 e tutje. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike shpenzimet mujore të konsumatorit me njehsorin elektrik nr.6723943:

- për periudhën 01/2017 është **469 kWh**,
- periudhën 02/2017 është **463 kWh**,
- periudhën 01/2018 është **489 kWh**
- periudhën 02/2018 është **429 kWh**,

ndërsa, me njehsorin kontestues nr.44169524

- për periudhën 01/2019 është **7,295 kWh**,
- për periudhën 02/2019 është **5,712 kWh**,

kurse me njehsorin e ri nr.44172125

- për periudhën 01/2020 është **3,443 kWh**,
- periudhën 02/2020 është **3,314 kWh**,
- periudhën 01/2021 është **1,247 kWh**,
- periudhën 02/2021 është **984 kWh**. Bazuar në rrjedhën e energjisë vëren se konsumatori me njehsorin elektrik nr.44169524 ka rritje të shpenzimit të energjisë elektrike në krahasim me njehsorin elektrik nr.6723943, si dhe me njehsorin e ri nr.44172125.

Lidhur me pretendimin tjetër se DMK si shkallë e parë vendimin e saj e bazon në rrjedhën e energjisë elektrike, Bordi thekson se rrjedha e energjisë elektrike është një nga provat më esenciale në procedurën e zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve në sektorin e energjisë, pasi që na mundëson që të kemi një pasqyrë të qartë të konsumit dhe profilit të një konsumatori në përgjithësi. Gjithsesi, krahas rrjedhës së energjisë, Bordi ka analizuar me kujdes edhe procesverbalet, faturat dhe dokumentet tjera relevante si në shkresat e lëndës.

Siç edhe është cekur në vendimin e kontestuar, nga KESCO është kërkuar që të ofroj procesverbalin e shqyrtimit të saktësisë së matjes, por që KESCO ka kthyer përgjigje se i njëjti nuk është shqyrtuar në mungesë të licencimit të laboratorit të QK. Pra, nga rrjedha e energjisë shihet qartë se shpenzimi i energjisë elektrike ka qenë më i lartë se me dy njehsorët e tjerë që nga momenti i montimit të tij, si dhe duke pasur parasysh që njehsorit elektrik nr. 44169524 nuk i është bërë shqyrtimit i saktësisë së matjes, atëherë më të drejtë, Bordi ka vlerësuar se shpenzimi i energjisë elektrike me njehsorin elektrik nr.44172125 nuk paraqet shpenzim real dhe si i tillë duhet të korrigjohet.



Andaj, duke u bazuar në nenin 28 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme), 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit dhe 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktajnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”. Në këtë kuptim, është vendosur si në dispozitiv të vendimit.*

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit R.M. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar